



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri**

**Konferencë për Shtyp  
Ambasadori Osmo Lipponen, Kryetari i Prezencës  
28 shtator 2004**

Sot është dita ime e fundit në Shqipëri kësaj here dhe, dy vjet pas kryesimit të Prezencës së OSBE-së, unë do të paraqes raportin tim përfundimtar para Këshillit të Përhershëm të OSBE-së në Vjenë ditën e enjten. Ky raport është një përmbledhje e hollësishme që përqendrohet kryesisht tek veprimtaritë dhe projektet e Prezencës. Qëllimi i këtij raporti është të tregojë se ndërkohë që, Prezenca ka shprehur shqetësimet e saj për një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me zhvillimin demokratik dhe institucional të Shqipërisë, ajo, së bashku me autoritetet shqiptare po zbaton, gjithashtu, një sërë projektesh të hartuara në mënyrë që t'i trajtojë këto shqetësime dhe mbështesë ndryshimet positive.

Sigurisht që, ndër këto çështje, parësore është reforma zgjedhore. Pavarësisht nga disa përmirësime, Shqipëria ende nuk ka mundur që të kapërcejë momentin kur zgjedhjet përbëjnë fokusin kryesor të vëmendjes dhe burim për tensione politike, veçanërisht, kur ka pasur një përparim të dukshëm në zhvillimin institucional në fusha të tjera në vend. Me afrimin e shpejtë të zgjedhjeve parlamentare, këmbana paralajmëruese ka rënë tashmë, pikërisht, nga Bashkimi Evropian në deklaratën e tij të kohëve të fundit, të cilën edhe Prezenca e ka mbështetur fuqimisht.

Megjithëse reforma zgjedhore është tani në proces, ajo, në fillim, ka vuajtur nga disa vonesa. Shohim se puna e komisionit të posaçëm është bllokuar aktualisht pa patur ndonjë arritje përtej propozimeve të marra nga Grupi i Ekspertëve Teknikë. GET-i ka punuar me të vërtet nën një presion shumë të madh për hartimin e ndryshimeve për përbërjen e KQZ-së, përmirësimin e listave të zgjedhësve, si dhe përbërjen dhe punën e komisioneve zgjedhore të nivelit të mesëm dhe të ulët për rishikim nga komisioni i posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore.

Por çështja e reformës zgjedhore nuk qëndron në të vërtet tek propozimet ligjore apo teknike që bëhen. Në të vërtet, kjo është një çështje e vullnetit politik – vullnetit politik të politikanëve të Shqipërisë për të zhvilluar zgjedhje demokratike sipas standarteve ndërkombëtare.

Përsa i përket çështjes tjetër madhore të kthimit dhe kompensimit të pronave, raporti ynë njih arritjen e miratimit të ligjit. Ne punuam deri në momentin e fundit, në mënyrë që të ruhej konsensusi për ligjin. Megjithatë, për këto arsye të sipërpërmendura, si dhe për arsye thelbësore, Prezenca pati rezervat e saj në lidhje me disa ndryshime që iu bënë ligjit në minutën e fundit. Gjithsesi, miratimi i ligjit shënon një arritje të rëndësishme Tani, Prezenca do të japë një kontribut të rëndësishëm për

hartimin e akteve nënligjore dhe akteve të tjera, si dhe, veçanërisht, për regjistrimin e pronës dhe ndërgjegjësimin e përgjithshëm për ligjin.

Përsa i përket luftës kundër trafikimit dhe krimit të organizuar, Prezenca ka punuar për të mbështetur strukturat shtetërore në fushat e mbrojtjes së dëshmitarëve, sekuestrimit të pasurive dhe pastrimit të parave, si dhe ka nxitur fushatën e ndërgjegjësimit për të drejtat e grave dhe luftës kundër trafikimit. Gjithashtu, dje, Prezenca i dhuroi policisë kufitare shqiptare gjithë rrjetin e saj të radiondërlidhjes që mbulon gjithë vendin.

Në fushën e shtetit të së drejtës, ne kemi studiuar sektorin juridik dhe kemi ofruar një sërë rekomandimesh në Analizën tonë të Sistemit Ligjor dhe sapo kemi përfunduar së fundi një studim me të hollësishëm mbi Gjykatën e Krimeve të Rënda, për të cilën do të jepem së shpejti edhe rekomandime. Ne po punojmë, gjithashtu, për nxitjen e të drejtave të arsimimit të pakicave, të drejtave të punëtorëve, drejtësisë për të miturit dhe standarteve në qelitë e paraburgimit.

Prezenca po mbështet një rrjet kombëtar të qendrave për zhvillimin e shoqërisë civile dhe ka ndërmarrë projekte për nxitjen e sipërmarrjes së të rinjve, ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit, mbështetjen për njërëzitet me aftësi të kufizuara dhe rolin e gruas në shoqëri.

Në përgjithësi, jam i kënaqur që kam qënë dëshmitar i një zhvillimi dinamik të Kuvendit shqiptar. Ky organ është bërë me të vërtet një forum për debat politik dhe madje edhe për kompromise të mundshme. Kuvendi po bën një përparim të madh për t'u modernizuar, ku edhe ne po japim ndihmesë për të përballuar sfidat dhe kërkesat në rritje ndaj ti. Si institucion, ai ka filluar të piqet në drejtimin pozitiv.

Në mbyllje, këto dy vitet e fundit kanë qënë shumë të këndshme për mua, dhe, siç mund ta shihni nga veprimtaritë e përshkruara shkurtimisht këtu, ka qënë një punë e madhe dhe e vështirë. Janë bërë shumë arritje të rëndësishme. Unë do të largohem me kujtime të mira për Shqipërinë dhe shqiptarët dhe jam shumë optimist për shanset e Shqipërisë për një rritje dhe zhvillim në të ardhmen.